



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE



United Nations
ALBANIA



Empowered lives.
Resilient nations.

BARAZIA



Leave
No One
Behind

@ UNDP


Tiranë, Korrik 2018

Autore: Sidita Fortuzi

Ndalohet shitja apo përdorimi i këtij udhëzuesi për qëllime përfitimi

Ky udhëzues u realizua përmes programit “Askush të mos mbetet pas”, financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim e Bashkëpunim, SDC, dhe zbatuar nga UNDP.

Mendimet e shprehura në këtë udhëzues u përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP.



Seksioni “Barazia” përmbledh legjislacionin që rregullon barazinë për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë seksion gjendet informacion mbi:

Ligji Nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

Fletore Zyrtare Nr. 15, 25 Shkurt 2010

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2010/PDF-2010/15-2010.pdf

Ligji Nr. 111/2017, datë 14.12.2017 Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti

Fletore Zyrtare Nr. 241

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202017/Fletore%20241/LIGJ%20nr.%20111-2017,%20date%2014.12.2017.pdf>

Ligj nr. 93/2014 Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara Nr. 93/2014

Fletore Zyrtare Nr. 135 28 Gusht 2014

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/135-2014.pdf

Plani Kombëtar i Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2016-2020, Fletore Zyrtare Nr. 124, 7 Korrik 2016

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/124-2016.pdf

Çfarë parashikon Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara?

Neni 5

Barazia dhe mosdiskriminimi

1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.
2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimii për shkak të aftësisë së kufizuar dhe tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në cdo rrethanë.
3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimin e diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arësyeshem.
4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuar nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Çfarë është diskriminimi?

“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo nga këto shkaqe: gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, mosha, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose çdo shkak tjetër, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe në ligjet në fuqi.

Cili është qëllimi i këtij ligji?

Ky ligj synon të sigurojë për të gjithë personat që përfitojnë prej tij barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike dhe njëkohësisht mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. (Neni 1)

Si mund të shfaqet diskriminimi? Cilat janë llojet e tij?

1. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo nga shkaqet e sipërpërmendura të këtij ligji.
2. “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, të sipërpërmendur në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.
3. “Diskriminim për shkak të shoqërimit” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.

4. “Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilindo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cënimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përcmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.
5. “Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Ku ndalohet diskriminimi?

Punësimi

Ndalohet diskriminimi në vendin e punës për shkak të aftësisë së kufizuar që nga momenti i shpalljes së vendit të punës, rekrutimit apo përzgjedhjes, trajtimit në lidhje me ngritjen profesionale, trajnimet e ndryshme, dhe deri në zgjidhje të kontratës.

Arsimi

Ndalohet diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar në arsim. Kjo zbatohet në çdo institucion, publik apo privat, në trajtimin e studentëve gjatë pranimit të tyre në këto institucione arsimore, vlerësimit dhe në masat që ndërmerren për çështje disiplinore, gjatë gjithë veprimtarisë arsimore, në programet arsimore dhe metodat e mësimdhënies.

Të mirat dhe shërbime

Përbën diskriminim çdo refuzim për dhënien apo ofrimin e shërbimeve për shkaqet e përmendura dhe në shërbimet që ofrohen në përgjithësi. Shembuj në lidhje me ofrimin e të mirave apo shërbimeve mund të jenë: hotelet, lokalet, baret, restorantet, firmat e ndërtimit, kinematë, teatrot, spitalet apo klinikat, transporti publik, gjykatat dhe institucione të ndryshme publike. Ligji cilëson që këto mund të jenë të mira apo shërbime të ofruara nga operatorët privatë apo shtetërorë. Ky refuzim vecanërisht ka të bëjë me:

- Mundësitë për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t’u përdorur nga publiku;
- mundësitë për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;
- kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;
- sistemimin në një vend ku ofrohet strehim; shitjen ose dhënien me qira të banesave dhe të mjediseve të tjera;
- shërbimet e bankës dhe mundësi për të siguruar grande, huadhënie, depozita bankare ose financim;
- lehtësitë për argëtim, çlodhje e freskim;
- lehtësitë për transport ose udhëtim;
- Ka raste dhe situata në të cilat lejohet një trajtim i ndryshëm për shkak të karakteristikave të sipërpërmendura dhe në këto raste kemi të bëjmë me atë që quhet trajtim i ndryshëm i përligjur.

Si të ankohemi dhe ku?

Para komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi:

Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal. Duhet mbajtur mend që në rastin e organizatës, organizata me interesa legjitime paraqet prokurë të posaçme për të përfaqësuar personin ose grupin e personave.

Në gjykatë:

Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërbllim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale.

Cilat janë kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi?

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri shqyrton të gjitha kërkesat e individëve apo organizatave që kanë interes të ligjshëm dhe ka te drejte të kryejë hetime administrative kur merr informacion të besueshëm. Komisioneri gjithashtu monitoron zbatimin e këtij ligji, nxit parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe informimit duke pasur në vëmendje që të përdoret gjuha e pakicave të caktura, gjuha e përdorur nga persona me aftësi të kufizuar dhe këtu ka parasysh, gjuhën e shenjave, shkrimin Braille dhe forma të tjera të komunikimit. Komisioneri gjithashtu mund të japë mendimin e tij në lidhje me çdo çështje diskriminimi në gjykatë, kur i kërkohet nga kjo e fundit. Ai mund të përfaqësojë gjithashtu ankuesit që kanë paraqitur kërkesëpadi në gjykatë kur pretendojnë të jenë diskriminuar.

Çfarë duhet të përmbajë ankesa?

Ankesa përmban:

- a) emrin e ankuesit;
- b) shpjegimin se si mund të kontaktohet ankuesi;
- c) subjektin që pretendohet të ketë kryer diskriminimin, ose shpjegim për pamundësinë e identifikimit të tij;
- ç) shpjegimin e diskriminimit të pretenduar;
- d) masat që kërkohen nga komisionari;
- dh) datën dhe firmën e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij.

Me marrjen e ankesës, komisioneri njofton brenda një afati kohor prej 15 ditësh personin fizik apo juridik kundër të cilit është bërë ankesa. Komisioneri fillon procesin e verifikimit të fakteve të paraqitura. Ai gjatë këtij procesi mund të marrë informacion nga çdo burim i nevojshëm dhe mund t'i kërkojë personit kundër të cilit është paraqitur ankesa që të paraqesë brenda 30 ditëve parashtrimet e veta në lidhje me diskriminim e pretenduar.

Refuzimi i ankesës

Nëqoftëse ankesa është anonime, e pabazuar apo nuk ofron informacion të mjaftueshëm për të filluar hetim, ajo mund të refuzohet nga komisioneri. Ankesa refuzohet gjithashtu nëqoftëse e njëjta ankesë po shqyrtohet në kuadër të një ankesë tjetër që është në shqyrtim. Kur komisioneri e sheh të arsyeshme, mund të organizojë një seancë dëgjimore me qëllim arritjen e një marrëveshjeje pajtimi midis palëve. Personat apo organizatat nuk paguajnë për paraqitjen e një ankesë apo shqyrtimin e saj nga ana e komisionerit.

* Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar që t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale.

Ligji “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

Cili është qëllimi i këtij ligji?

Ky ligj ka si qëllim: a) të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; b) të sigurojë mirëorganizimin, mirëadministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike; c) të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efçente dhe efektive.

Çfarë është ndihma juridike?

Ndihmë juridike” është shërbimi juridik falas dhe shërbimet e tjera të parashikuara në këtë ligj, siç është përjashtimi nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, për personat që përmbushin kriteret, të cilat garantohen dhe financohen nga shteti.

Cilat janë format e ofrimit të kësaj ndihme?

“Ndihmë juridike parësore” është: i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor; ii) dhënia e këshillimit; iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve; iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore; v) përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

“Ndihmë juridike dytësore” është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal. ç) “Këshillim” është dhënia e informacionit mbi mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje konkrete juridike.

Ndihma juridike jepet në format e mëposhtme:

- a) ndihmë juridike parësore;
- b) ndihmë juridike dytësore;
- c) përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas ligjit.

Kush përfiton nga ndihma juridike?

Ndihma juridike i ofrohet pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

- a) viktimat të dhunës në familje;
- b) viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- c) viktimat të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- ç) fëmijë, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- d) fëmijë nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- dh) persona që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- e) persona, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- ë) persona, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- f) persona, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- g) persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- gj) persona, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- h) persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Si mund të përfitojnë personat me aftësi të kufizuara nga ndihma juridike parësore?

Paraqiten pranë një qendre shërbimi për ndihmë juridike parësore ose një organizate jofitimprurëse të autorizuar dhe bëjnë një kërkesë me gojë ose me shkrim.

Personi nënshkruan një vetëdeklarim që përmbush kriteret e përcaktuara në ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Dorëzon vetëdeklarimin e shoqëruar me dokumentacionin justifikues, për shembull dokument që vërteton që merr pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar.

*Lista e dokumenteve përcaktohet në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë.

Ndihma juridike parësore i ofrohet menjëherë me marrjen e kërkesës.

Në rast se dhënia e menjëhershme e ndihmës juridike parësore është e pamundur, personi informohet menjëherë për datën dhe kohën e dhënies së shërbimit të kërkuar.

Në rast se gjatë dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore ka nevojë për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, personi informohet menjëherë për kushtet e dhënies së ndihmës juridike dytësore dhe ndihmohet për plotësimin e kërkesës.

Si përfitojnë personat nga ndihma juridike dytësore?

Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore.

Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet nga personi i interesuar personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë gjykatës ose organit procedues që fillon hetimet, përpara fillimit të një procesi gjyqësor, në fillim të një procesi gjyqësor dhe/ose në çdo fazë të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural.

Personi që gëzon të drejtën për ndihmë juridike dytësore, mund ta paraqesë kërkesën nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor apo të pajisur me prokurë, ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose një të afërmi të shkallës së pare.

Kërkesa për ndihmë juridike dytësore përjashtohet nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmë juridike dytësore, nënshkruan një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përfitimit dhe e shoqëron atë me dokumentacionin justifikues. Lista e dokumenteve që shërbejnë për vërtetimin e përmbushjes së kriteve përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore përjashtohen nga

- a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;
- b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural;
- c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarrimor gjyqësor shtetëror.

Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara

Si garanton ligji barazinë?

Përmes mbrojtjes nga diskriminimi:

- a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga aftësia e kufizuar që kanë;
- b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta;
- c) autonomia e personave me aftësi të kufizuara dhe respektimi i pavarësisë së vendimmarrjes së personave me aftësi të kufizuara.

Çfarë do të thotë jetesë e pavarur sipas këtij ligji?

Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.

Çfarë është vendimarrja e mbështetur?

- “Vendimarrje e mbështetur” është ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundur kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.
- Çdo person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për ndihmë në vendimarrje, merr mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, përfshirë mbështetjen me anë të interpretimit dhe gjuhës së thjeshtë, si dhe ndihmën në marrëdhëniet e personit me palë të treta, që nuk mund të kuptojnë mënyrat e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht, duke u dhënë kohë të mjaftueshme personave që e kërkojnë atë, për të mësuar se si mund ta përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.
- Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Plani Kombëtar i Veprimit për PAK, barazia

Çfarë ka marrë përsipër Plani Kombëtar i Veprimit për PAK në lidhje me barazinë?

- Qeveria ka marrë përsipër të rrisë numrin e personave me aftësi të kufizuara, të kualifikueshëm për ndihmë juridike falas, që përdorin shërbimet e ndihmës juridike falas;
- Të sigurojë barazinë para ligjit të të gjithë personave me aftësi të kufizuara;
- Të garantojë që të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në sistemin e drejtësisë të respektohen në përputhje me standardet ndërkombëtare.

